

BANKA E SHQIPËRISË

B U L E T I N I
Z Y R T A R

vëllimi 26 numër 3 prill 2024

Data e botimit: 19.4.2024

P Ë R M B A J T J A

1. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 15, datë 6.3.2024
"Për një ndryshim në rregulloren "Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit"" 5
2. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 16, datë 6.3.2024
"Për shtypjen e monedhës metalike përkujtimore, për qëllime numizmatike, me tematikë "100 vjet Banka e Shqipërisë, 1925-2025"" 7
3. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 17, datë 20.3.2024
"Për mbajtjen e pandryshuar të normës së interesit të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjella të riblerjes dhe të normave të interesit të depozitës njëditore dhe të kredisë njëditore në Bankën e Shqipërisë". 9
4. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 18, datë 20.3.2024 "Për miratimin e pasqyrave financiare të Bankës së Shqipërisë për vitin 2023" 11
5. Vendim i Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë, nr.prot. 1481, datë 2.4.2024
"Për caktimin e shtesave makroprudenciale të kapitalit" 12
6. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 21, datë 3.4.2024
"Për miratimin e rregullores "Për përcaktimin e kërkesave për transfertat e kreditit dhe të debitimit direkt në euro"" 14
7. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 24, datë 3.4.2024
"Për rishtypjen e kartëmonedhës shqiptare me kurs ligjor, me prerje 200 Lekë dhe 500 Lekë" 26

8. Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar, vëllimi 26, numër 1, janar 2024 27
9. Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar, vëllimi 26, numër 2, shkurt 2024 27



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS

VENDIM
Nr. 15, datë 6.3.2024

PËR
NJË NDRYSHIM NË RREGULLOREN
“PËR RAPORTIN E MJAFTUESHMËRISË SË KAPITALIT”

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12 shkronja “a”, dhe nenit 43 shkronja “c”, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar; të nenit 58, shkronjat “a”, “b”, “c” dhe “ç”, dhe të nenit 60, pika 2, të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë

VENDOSI:

1. Në rregulloren “Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit”, miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 48, datë 31.7.2013, e ndryshuar, të bëhet ndryshimi i mëposhtëm:

Në nenin 25, pika 3, shkronja “d”, pas togfjalëshit “*nëpërmjet filialeve, degëve ose agjencive të saj*”, shtohet togfjalëshi “, me përjashtim të vlerës së kredisë së akorduar në Republikën e Kosovës”.

2. Ngarkohen bankat e licencuara nga Banka e Shqipërisë me zbatimin e këtij vendimi.
3. Ngarkohen Departamenti i Mbikëqyrjes dhe Departamenti i Statistikave Financiare për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.
4. Ngarkohen Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

SEKRETARI

ELVIS ÇIBUKU

KRYETARI

GENT SEJKO



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS

VENDIM
Nr. 16, datë 6.3.2024

PËR
SHTYPJEN E MONEDHËS METALIKE PËRKUJTIMORE, PËR QËLLIME
NUMIZMATIKE, ME TEMATIKË
“100 VJET BANKA E SHQIPËRISË, 1925-2025”

Në bazë dhe për zbatim të pikës 3 të nenit 33, pikës 2 të nenit 39 dhe të nenit 43 shkronja “d” të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar; të nenit 4 pika 4, dhe nenit 5 të rregullores “Për procedurat e krijimit dhe shtypjes së monedhave dhe kartëmonedhave pa kurs ligjor, përkujtimore për qëllime numizmatike dhe medaljoneve përkujtimore, nga Banka e Shqipërisë”, miratuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr. 12, datë 7.2.2024; vendimit të Këshillit Mbikëqyrës nr. 5, datë 24.1.2024, për miratimin e “Strategjisë të Bankës së Shqipërisë për krijimin e monedhave pa kurs ligjor, përkujtimore dhe për qëllime numizmatike për 2024-2029”; si dhe bazuar në nenin 14, shkronja “s”, të rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Departamentit të Kërkimeve”, të miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 42, datë 30.3.2016; me propozim të Departamentit të Kërkimeve, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë

VENDOSI:

1. Të miratojë shtypjen për vitin 2025 të monedhës përkujtimore për qëllime numizmatike, pa kurs ligjor, me tematikë “100 vjet Banka e Shqipërisë, 1925-2025”, me të dhënat teknike si më poshtë:

Vlera emërore	Tirazhi	Të dhënat teknike					
		Materiali dhe pastërtia	Pesha	Diametri	Anët e monedhës	Teknika	Cilësia e shtypit
100 Lekë	500 copë	925/1000 Ag	30.00 g (± 0.3 g)	40.00 mm (± 0.1 mm)	Dekor ose germa	Me ngjyra dhe ose 3D dhe ose relief shumë i ngritur	Provë - proof

2. Trajtimi i tematikës në konfigurimet e monedhës sipas pikës 1 të këtij vendimi të jetë i lirë, duke respektuar:
 - a) në pamjen kryesore të ketë të shkruar vlerën emërore;
 - b) në pamjen e pasme të ketë të shkruar "Shqipëri–Albania 2025"; dhe
 - c) përshkrimin e tematikës në njëren pamje të monedhës "100 vjet Banka e Shqipërisë, 1925-2025".
3. Tirazhi i shtypjes së prerjes përkujtimore të përcaktuar si në pikën 1 është 500 copë, i ndarë sipas nënfondeve të fondit numizmatik të Bankës së Shqipërisë, si më poshtë:
 - a) Fond i Paprekshëm – 5 copë;
 - b) Fond Numizmatik për Muzeun – 4 copë;
 - c) Fond për Dhurata – 200 copë;
 - d) Fond për Shitje – 291 copë.
4. Ngarkohet Departamenti i Kërkimeve për publikimin dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI

ELVIS ÇIBUKU

KRYETARI

GENT SEJKO



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS

VENDIM
Nr. 17, datë 20.3.2024

PËR
MBAJTJEN E PANDRYSHUAR TË NORMËS SË INTERESIT TË
MARRËVESHJEVE TË RIBLERJES DHE TË ANASJELLA TË RIBLERJES DHE
TË NORMAVE TË INTERESIT TË DEPOZITËS NJËDITORE DHE TË KREDISË
NJËDITORE NË BANKËN E SHQIPËRISË

Në bazë dhe për zbatim të nenit 43, shkronjat "a" dhe "c" të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", të ndryshuar; me propozimin e Departamentit të Politikës Monetare, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të mbajë të pandryshuar, në nivelin 3.25 për qind, normën e interesit të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjella të riblerjes (REPO dhe REPO të anasjella).
2. Të mbajë të pandryshuar, në nivelin 2.25 për qind, normën e interesit që Banka e Shqipërisë i paguan një banke tregtare për depozitën njëditore.
3. Të mbajë të pandryshuar, në nivelin 4.25 për qind, normën e interesit që një bankë tregtare i paguan Bankës së Shqipërisë për kredinë njëditore.
4. Ngarkohet Departamenti i Operacioneve Monetare të njoftojë menjëherë bankat tregtare për këtë vendim.
5. Ngarkohen Departamenti i Operacioneve Monetare dhe të gjitha strukturat e tjera në Bankën e Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

6. Ngarkohen Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve për publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në faqen zyrtare të internetit dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI

KRYETARI

ELVIS ÇIBUKU

GENT SEJKO



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS**

**VENDIM
Nr. 18, datë 20.3.2024**

**PËR
MIRATIMIN E "PASQYRAVE FINANCIARE TË BANKËS SË SHQIPËRISË PËR
VITIN 2023"**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 43, shkronja "l" dhe të nenit 69, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar; me propozim të Departamentit të Sistemeve të Pagesave, Kontabilitetit dhe Financës, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë "Pasqyrat financiare të Bankës së Shqipërisë për vitin 2023", bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Pasqyrat financiare të miratuara sipas pikës 1 të këtij vendimi dhe opinionit i audituesit të jashtëm, janë pjesë përbërëse e Raportit Vjetor të Bankës së Shqipërisë për vitin 2023.
3. Ngarkohen me zbatimin e këtij vendimi Departamenti i Sistemeve të Pagesave, Kontabilitetit dhe Financës dhe Departamenti i Politikës Monetare.
4. Ngarkohet Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI

ELVIS ÇIBUKU

KRYETARI

GENT SEJKO



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
GUVERNATORI

Nr. 1481 prot.

Tiranë, më 2.4.2024

VENDIM
Nr. 1481, datë 2.4.2024

PËR
CAKTIMIN E SHITESAVE MAKROPRUDENCIALE TË KAPITALIT

Në bazë dhe për zbatim të neneve 11, 12, 14 dhe nenit 16, pika 1, shkronja "ç" dhe "d", të rregullores "Për shtesat makroprudenciale të kapitalit" miratuar me vendimin nr. 41, datë 5.6.2019 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, bazuar në propozimin e Departamentit të Stabilitetit Financiar,

VENDOSA:

1. Norma e shtesës kundërciklike të kapitalit (KUNC) për Shqipërinë është 0 për qind, dhe do të përmbushet duke filluar nga data 31 mars 2025.
2. Bankat me rëndësi sistemike (BARS) dhe shtesat përkatëse të kapitalit (SIST), përcaktohen si me poshtë:

BARS	Vlerësimi për SIST-in total	SIST-i për periudhën 1 janar – 31 dhjetor, 2025
Banka Kombëtare Tregtare sh.a.	1.5 për qind	1.5 për qind
Banka Credins sh.a.	1.0 për qind	1.0 për qind
Banka Raiffeisen sh.a.	1.0 për qind	1.0 për qind
Banka OTP Albania sh.a.	0.5 për qind	0.5 për qind

3. Shtesat makroprudenciale të kapitalit sipas pikave 1 dhe 2 të këtij vendimi, zbatohen së bashku me shtesën konservuese të kapitalit (KONS) sipas tabelës 2, të nenit 10, pika 1, të rregullores 41/2019, ku vlera e KONS-it në vijimësi është në nivelin 2.5 për qind.

4. Shtesat makroprudenciale të kapitalit, sipas pikës 3 të këtij vendimi, zbatohen dhe mbahen në nivel institucioni të veçantë (*solo basis*).
5. Ngarkohen Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve për publikimin e këtij vendimi në faqen e internetit dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.
6. Ngarkohen Departamenti i Stabilitetit Financiar dhe Departamenti i Mbikëqyrjes me ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

GUVERNATOR

GENT SEJKO



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS

VENDIM
Nr. 21, datë 3.4.2024

PËR
MIRATIMIN E RREGULLORES "PËR PËRCAKTIMIN E KËRKESAVE PËR
TRANSFERTAT E KREDITIT DHE TË DEBITIMIT DIREKT NË EURO"

Në bazë dhe për zbatim të nenit 1, pika 4, shkronja "b", nenit 21 dhe nenit 43, shkronja "c" të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar; nenit 129 të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; nenit 15, pika 1 të ligjit nr. 133, datë 30.4.2013 "Për sistemin e pagesave"; dhe titujve III, IV dhe V të ligjit nr. 55, datë 30.4.2020 "Për shërbimet e pagesave"; me propozimin e Departamentit të Sistemeve të Pagesave, Kontabilitetit dhe Financës, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë rregulloren "Për përcaktimin e kërkesave për transfertat e kreditit dhe të debitimit direkt në Euro", sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohen ofruesit e shërbimeve të pagesave përcaktuar në nenin 3, pika 2 të ligjit nr. 55, datë 30.4.2020 "Për shërbimet e pagesave", për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ngarkohen Departamenti i Sistemeve të Pagesave, Kontabilitetit dhe Financës dhe Departamenti i Mbikëqyrjes në Bankën e Shqipërisë me ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.
4. Ngarkohen Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

SEKRETARI

KRYETARI

ELVIS ÇIBUKU

GENT SEJKO

Neni 1 Objekti dhe fusha e zbatimit

1. Kjo rregullore përcakton kërkesat për transaksionet e transfertave të kreditit dhe të debitimit direkt të kryera në monedhën Euro brenda Shqipërisë dhe ndërmjet Shqipërisë dhe zonës SEPA, ku si OShP-ja e pagesit ashtu edhe OShP-ja e përfituesit janë në Shqipëri ose një nga OShP-të është në Shqipëri dhe tjetri brenda zonës SEPA, ose i vetmi OShP i përfshirë në transaksionin e pagesës ndodhet në Shqipëri.
2. Kjo rregullore zbatohet pa rënë ndesh me kërkesat e legjislacionit për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit, si dhe rregullat që administrojnë ekzekutimin e transfertave të kreditit dhe transaksioneve të debitimit direkt në Lekë.
3. Kjo rregullore do të zbatohet edhe për transfertat e kreditit dhe debitimet direkte në Lekë, për aq sa është e mundur nga pikëpamja teknike dhe operacionale.

Neni 2 Përjashtimet

1. Kjo rregullore nuk zbatohet për:
 - a) Transaksionet e pagesave të kryera ndërmjet dhe brenda OShP-ve, duke përfshirë agjentët ose degët e tyre, për llogari të tyre;
 - b) Transaksionet e pagesave të procesuara dhe të shlyera përmes sistemeve të pagesave me vlerë të madhe, duke përjashtuar transaksionet e pagesave të debitimit direkt, për të cilat pagesi nuk ka kërkuar në mënyrë eksplicite të procesohen nëpërmjet një sistemi pagesash me vlerë të madhe;
 - c) Transaksionet e pagesave të kryera nëpërmjet një karte pagese ose pajisjeje të ngjashme, duke përfshirë tërheqjet e parave fizike (cash), përveç rastit kur karta e pagesës ose një pajisje e ngjashme përdoret vetëm për të gjeneruar informacionin e kërkuar, për të kryer drejtpërdrejt një transfertë krediti ose debitim direkt drejt dhe nga një llogari pagese e identifikuar nëpërmjet BBAN ose IBAN;
 - d) Transaksionet e pagesave të kryera me anë të çdo pajisjeje telekomunikacioni, digjitale ose TIK, nëse transaksione të tilla pagese nuk rezultojnë në një transfertë krediti ose debitimi direkt drejt dhe nga një llogari pagese e identifikuar nëpërmjet BBAN ose IBAN;
 - e) Transaksionet e dërgesave të parave të përcaktuara në nenin 5, pika 8 të ligjit nr. 55, datë 30.4.2020 "Për shërbimet e pagesave";
 - f) Transaksionet e pagesave që transferojnë para elektronike, përveç rasteve kur transaksione të tilla rezultojnë në një transfertë krediti ose debitimi direkt drejt dhe nga një llogari pagese e identifikuar nëpërmjet BBAN ose IBAN.

2. Kur skemat e pagesave bazohen në transaksionet e pagesave me transferta krediti ose debitime direkte, por kanë veçori ose shërbime shtesë opsionale, kjo rregullore zbatohet vetëm për transfertat e kreditit ose debitimeve direkte ku bazohet skema.

Neni 3 Përkufizime

1. Në këtë rregullore, termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:
 - a) "ALL" është monedha kombëtare Lekë;
 - b) "BBAN" është një identifikues i numrit të llogarisë së pagesës, i cili identifikon qartë një llogari individuale të pagesës me një OShP në Shqipëri dhe që mund të përdoret vetëm për transaksionet e pagesave kombëtare, ndërsa e njëjta llogari pagese identifikohet nga IBAN për transaksionet e pagesave ndërkufitare;
 - c) "BIC" është një kod identifikues biznesi, i cili identifikon qartë një OShP, elementet e të cilit përcaktohen nga ISO;
 - d) "Data e shlyerjes" është data në të cilën shlyhen detyrimet në lidhje me transferimin e fondeve ndërmjet OShP-së së paguesit dhe OShP-së së përfituesit;
 - e) "Debitim direkt" do të thotë një shërbim kombëtar ose ndërkufitar SEPA i pagesës për debitimin e llogarisë së pagesës së një paguesi, kur një transaksion pagese fillon nga përfituesi në bazë të pëlqimit të paguesit;
 - f) "EPC" është Këshilli Evropian i Pagesave;
 - g) "Financimi i terrorizmit" nënkupton financimin e terrorizmit të përcaktuar në ligjin nr. 9917, datë 19.5.2008 "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit", i ndryshuar;
 - h) "IBAN" është një identifikues ndërkombëtar i numrit të llogarisë së pagesës, i cili identifikon qartë një llogari individuale të pagesës, elementet e të cilit përcaktohen nga Organizata Ndërkombëtare për Standardizimin (ISO);
 - i) "ISO" është Organizata Ndërkombëtare për Standardizim;
 - j) "Kërkesë për arkëtim" nënkupton një pjesë të një transaksioni debitimi direkt, duke filluar nga inicimi i tij nga përfituesi deri në përfundimin e tij përmes debitimit normal të llogarisë së pagesës së paguesit;
 - k) "Ligji për shërbimet e pagesave" është ligji nr. 55, datë 30.4.2020 "Për shërbimet e pagesave" dhe/ose çdo ligj ndryshues i tij;
 - l) "Mandat" nënkupton shprehjen e pëlqimit dhe autorizimit të dhënë nga paguesi ndaj përfituesit dhe (direkt ose indirekt përmes përfituesit) ndaj OShP-së të paguesit për të lejuar përfituesin të iniciojë një kërkesë për arkëtim me anë të debitimit të llogarisë së pagesës të specifikuar të paguesit dhe për t'i lejuar OShP-së së paguesit të veprojë në pajtim me udhëzime të tilla;
 - m) "OSHP" është një ofrues i shërbimeve të pagesave;
 - n) "Pagesat SEPA" janë pagesa midis pjesëmarrësve të skemës së SEPA-s në formën e Transfertave të Kreditit SEPA dhe/ose

- Debitimeve Direkte SEPA;
- o) "Palë referencë" nënkupton një person fizik ose juridik, në emër të të cilit paguesi kryen një pagesë, ose përfituesi përfiton një pagesë;
 - p) "PShP" ose "përdorues i shërbimeve të pagesave" është një person fizik ose juridik që përdor shërbimet e pagesave në cilësinë e paguesit ose përfituesit të pagesave;
 - q) "SEPA" është Zona e Unike e Pagesave në Euro (*"the Single Euro Payments Area"*);
 - r) "Sistemi i pagesave me vlerë të madhe" është një sistem pagese, qëllimi kryesor i të cilit është të procesojë, klerojë ose shlyejë transaksione individuale të pagesave me prioritet dhe urgjencë të lartë, dhe kryesisht me shuma të mëdha;
 - s) "Sistemi i pagesave me vlerë të vogël" nënkupton një sistem pagesash qëllimi kryesor i të cilit është të procesojë, klerojë ose shlyejë transfertat e kreditit ose debitimet direkte, të cilat përgjithësisht grupohen për transmetim dhe janë kryesisht me shuma të vogla dhe me prioritet të ulët, dhe që nuk është një sistem pagesash me vlerë të madhe;
 - t) "Skema SEPA" çdo skemë e administruar dhe operuar nga EPC;
 - u) "Skemë pagese" nënkupton një grup të vetëm rregullash, praktikash, standardesh dhe/ose udhëzimesh zbatimi të rënë dakord ndërmjet OShP-ve për ekzekutimin e transaksioneve të pagesave brenda Shqipërisë dhe në të gjithë zonën e SEPA-s, dhe që është e ndarë nga çdo infrastrukturë ose sistem pagesash që mbështet funksionimin e saj;
 - v) "Standardi ISO 20022 XML" është një standard për zhvillimin e mesazheve financiare elektronike siç përcaktohet nga ISO, që përfshin paraqitjen fizike të transaksioneve të pagesave në sintaksën XML, në përputhje me rregullat e biznesit dhe udhëzimet e zbatimit të Shqipërisë ose të skemave të SEPA-s për transaksionet e pagesave që janë objekt i kësaj rregulloreje;
 - w) "Shtojca I" është shtojca bashkëlidhur kësaj rregulloreje që përcakton kërkesat teknike të aplikuara për transfertat e kreditit dhe debitimet dikërkte në SEPA, krahas nenit 4;
 - x) "TIK" nënkupton teknologjinë e informacionit dhe komunikimit (*"ICT"*);
 - y) "Transaksion pagese kombëtare" nënkupton një transaksion pagese të iniciuar nga një pagues ose nga një përfitues, ku OShP-ja e paguesit dhe OShP-ja e përfituesit janë të vendosur në Shqipëri;
 - z) "Transfertë krediti" nënkupton një shërbim pagese kombëtar ose ndërkufitar SEPA për kreditimin e llogarisë së pagesës së një përfituesi me një transaksion pagese ose një seri transaksionesh pagese nga llogaria e pagesës së një paguesi nga OShP-ja që mban llogarinë e pagesës së paguesit, bazuar në një udhëzim dhënë nga paguesi;
 - aa) "Zona SEPA" nënkupton shtrirjen gjeografike të skemave të SEPA-s, siç përcaktohet nga kriteret e vendosura nga Këshilli Evropian i Pagesave (*"EPC"*).

2. Përveç sa përcaktuar në pikën 1, termat e tjerë të përdorur në këtë rregullore do të kenë të njëjtin kuptim siç përcaktohet në Ligjin për shërbimet e pagesave.

Neni 4

Kërkesat për transaksionet e transfertave të kreditit dhe të debitimit direkt

1. Ofruesit e shërbimeve të pagesave kryejnë transaksione të transfertave të kreditit dhe të debitimit direkt në përputhje me kërkesat e mëposhtme:
 - a) duhet të përdorin identifikuesin e llogarisë së pagesave të specifikuar në pikën 1, shkronja "a" të Shtojcës I, për identifikimin e llogarive të pagesave, pavarësisht nga vendndodhja e OShP-së në fjalë;
 - b) duhet të përdorin formatet e mesazheve të specifikuara në pikën 1, shkronja "b" të Shtojcës I, kur transmetojnë transaksione pagese tek një OShP tjetër ose nëpërmjet një sistemi pagesash me vlerë të vogël;
 - c) duhet të sigurojnë që përdoruesit e shërbimeve të pagesave të përdorin identifikuesin e llogarisë së pagesës të specifikuar në pikën 1, shkronja "a" të Shtojcës I, për identifikimin e llogarive të pagesave, pavarësisht nëse OShP-ja e paguesit dhe OShP-ja e përfituesit ose e vetmja OShP në transaksionin e pagesës është në Shqipëri;
 - d) duhet të sigurojnë që për rastet kur një PShP që nuk është konsumator ose mikrondërmarrje, inicion ose merr transferta krediti individuale, ose debitime direkte individuale, të cilat nuk transmetohen individualisht, por janë të grupuara për transmetim, të përdoren formatet e mesazheve të përcaktuara në pikën 1, shkronja "b" të Shtojcës I.
2. Pa cenuar pikën 1, shkronja "b", OShP-të, me kërkesë specifike të një PShP-je, do të përdorin formatet e mesazheve të përcaktuara në pikën 1, shkronja "b" të Shtojcës I, në lidhje me atë PShP.
3. Ofruesit e shërbimeve të pagesave do të kryejnë transfertë krediti në përputhje me kërkesat e mëposhtme, subjekt i çdo detyrimi të përcaktuar në legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale:
 - a) OShP-ja e paguesit duhet të sigurojë që paguesi ofron elementet e të dhënave të përcaktuara në pikën 2, shkronja "a" të Shtojcës I;
 - b) OShP-ja e paguesit duhet t'i japë OShP-së së përfituesit elementet e të dhënave të përcaktuara në pikën 2, shkronja "b" të Shtojcës I;
 - c) OShP-ja e përfituesit duhet të sigurojë ose të vërë në dispozicion të përfituesit elementet e të dhënave të përcaktuara në pikën 2, shkronja "d" të Shtojcës I.

4. Ofruesit e shërbimeve të pagesave do të kryejnë debitim direkt në përputhje me kërkesat e mëposhtme, subjekti i çdo detyrimi të përcaktuar në legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale:
- a) OShP-ja e përfituesit duhet të sigurojë që:
 - i. përfituesi siguron elementet e të dhënave të specifikuar në pikën 3, shkronja "a" të Shtojcës I në debitimin e parë direkt dhe në debitimin direkt të vetëm, si dhe në çdo transaksion pagese të njëpasnjëshëm;
 - ii. paguesi jep pëlqimin si për përfituesin, ashtu edhe për OShP-në e paguesit (direkt ose indirekt nëpërmjet përfituesit), që mandatet, së bashku me ndryshimet ose anulimet e mëvonshme, të ruhen nga përfituesi ose nga një palë e tretë në emër të përfituesit dhe përfituesi vihet në dijeni për këtë detyrim nga OShP-ja në përputhje me nenet 44 dhe 45 të Ligjit për shërbimet e pagesave;
 - b) OShP-ja e përfituesit duhet t'i sigurojë OShP-së së paguesit elementet e të dhënave të përcaktuara në pikën 3, shkronja "b" të Shtojcës I;
 - c) OShP-ja e paguesit duhet të sigurojë ose të vërë në dispozicion të paguesit elementet e të dhënave të përcaktuara në pikën 3, shkronja "c" të Shtojcës I;
 - d) Paguesi duhet të ketë të drejtën të udhëzojë OShP-në e tij:
 - i. të kufizojë arkëtimin e debitimit direkt në një shumë ose periodicitet të caktuar ose të dyja;
 - ii. kur një mandat sipas një skeme pagese nuk parashikon të drejtën e rimbursimit, të verifikojë çdo transaksion të debitimit direkt dhe të kontrollojë nëse shuma dhe periodiciteti i transaksionit të debitimit direkt është e barabartë me shumën dhe periodicitetin e rënë dakord në mandat, përpara debitimit të llogarisë së tij të pagesave, dhe bazuar në informacionin e mandatit;
 - iii. të bllokojë çdo debitim direkt në llogarinë e pagesave të paguesit ose të bllokojë çdo debitim direkt të iniciuar nga një ose më shumë përfitues të specifikuar ose të autorizojë debitime direkte të iniciuara vetëm nga një ose më shumë përfitues të specifikuar.
 - e) Kur as paguesi dhe as përfituesi i pagesës nuk janë konsumator, OShP-ve nuk u kërkohet të respektojnë pikën 4, shkronjën "d", paragrafi (i), (ii) ose (iii) të këtij neni;
 - f) OShP-ja e paguesit do të informojë paguesin për të drejtat e përmendura në pikën 4, shkronja "d" të këtij neni, në përputhje me nenet 44 dhe 45 të Ligjit për shërbimet e pagesave;
 - g) Me transaksionin e parë të debitimit direkt ose një transaksion të vetëm të debitimit direkt, dhe pas çdo transaksioni të njëpasnjëshëm të debitimit direkt, përfituesi do t'i dërgojë informacionin lidhur me mandatin OShP-së së tij dhe OShP-ja e përfituesit do ta transmetojë informacionin në lidhje me mandatin tek OShP-ja e paguesit, në çdo transaksion të debitimit direkt.

5. Përveç kërkesave të përmendura në pikat 1 dhe 2 të këtij neni, përfituesi që pranon transfertat e kreditit duhet t'u komunikojë pagesve të tij identifikuesin e llogarisë së tij të pagesës të specifikuar në pikën 1, shkronja "a" të Shtojcës I, kur kërkohet një transfertë krediti.
6. Përpara transaksioneve të para të debitimit direkt, pagesi duhet të komunikojë identifikuesin e llogarisë së tij të pagesës të specifikuar në pikën 1, shkronja "a" të Shtojcës I.
7. Kur marrëveshja kuadër ndërmjet pagesit dhe OShP-së së pagesit nuk parashikon të drejtën e rimbursimit, OShP-ja e pagesit, pa cenuar pikën 4, shkronja "a", paragrafi "ii" i këtij neni, do të verifikojë çdo transaksion të debitimit direkt për të kontrolluar nëse shuma e transaksionit të debitimit të direkt të dorëzuar është e barabartë me shumën dhe periodicitetin e rënë dakord në mandat përpara debitimit të llogarisë së pagesave të pagesit, bazuar në informacionin e mandatit.
8. Ofruesit e shërbimeve të pagesave nuk do të kërkojnë që përdoruesit e shërbimeve të pagesave të tregojnë BIC-un e OShP-së së një pagesi ose të OShP-së së një përfituesi.
9. OShP-ja e pagesit dhe OShP-ja e përfituesit nuk do të vendosin tarifa shtesë ose tarifa të tjera në procesin e leximit të informacionit për të gjeneruar automatikisht një mandat për ato transaksione pagese të nisura nëpërmjet, ose me anë të një karte pagese në pikën e shitjes, të cilat rezultojnë në debitim direkt.

Neni 5 **Sanksionet dhe ankimet**

1. Për shkelje të dispozitave të kësaj rregulloreje, Banka e Shqipërisë vendos gjobat e përcaktuara në nenin 94, pika 2 të Ligjit për shërbimin e pagesave.
2. Pikat 6 deri 15 të nenit 94, si dhe nenet 95, 96 dhe 97 të Ligjit për shërbimet e pagesave janë të zbatueshme për çdo shkelje të dispozitave të kësaj rregulloreje.

Neni 6 **Procedurat për zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve**

Procedurat për zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve të përcaktuara në nenet 92 dhe 93 të Ligjit për shërbimet e pagesave janë të zbatueshme për çdo mosmarrëveshje në lidhje me të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga kjo rregullore ndërmjet PShP-ve dhe OShP-ve të tyre.

Neni 7 Të fundit

Me qëllim aplikimin për pjesëmarrje të OShP-ve në SEPA, Banka e Shqipërisë bashkëpunon dhe nxit OShP-të që të marrin masat e nevojshme për përshtatjen e aktivitetit dhe funksionimin e tyre me kërkesat e kësaj rregulloreje brenda 180 (njëqind e tetëdhjetë) ditëve nga miratimi i zgjerimit të shtrirjes gjeografike të SEPA-s në Shqipëri, nga Këshilli Evropian i Pagesave.

Neni 8 Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë, me përjashtim të nenit 4, i cili hyn në fuqi pas miratimit të zgjerimit të shtrirjes gjeografike të SEPA-s në Shqipëri nga Këshilli Evropian i Pagesave.

KRYETAR I KËSHILLIT MBIKËQYRËS

GENT SEJKO

SHTOJCA I KËRKESAT TEKNIKE (NENI 4)

- 1) Përveç kërkesave thelbësore të përcaktuara në nenin 4, për transaksionet e transfertave të kreditit dhe të debitimit direkt zbatohen kërkesat teknike të mëposhtme:
 - a) identifikuesi i llogarisë së pagesave të përmendur në nenin 4, pika 1, shkronjat "a" dhe "c", duhet të jetë IBAN;
 - b) standardi për formatin e mesazhit të përmendur në nenin 4, pika 1, shkronjat "b" dhe "d" duhet të jetë standardi ISO 20022 XML.
 - c) fusha e të dhënave të dërgesave duhet të lejojë 140 karaktere. Skemat e pagesave mund të lejojnë një numër më të madh karakteresh, përveçse në rastin kur pajisja e përdorur për dërgimin e informacionit ka kufizime teknike në lidhje me numrin e karaktereve, ku në këtë rast zbatohet kufiri teknik i pajisjes;
 - d) informacioni i referencës së dërgesës dhe të gjitha elementet e tjera të të dhënave të ofruara në përputhje me pikat 2 dhe 3 të kësaj Shtojce I, duhet të transmetohen plotësisht dhe pa ndryshime ndërmjet OShP-ve në zinxhirin e pagesave;
 - e) pasi të dhënat e kërkuara të jenë të disponueshme në formë elektronike, transaksionet e pagesave duhet të lejojnë përpunimin plotësisht të automatizuar elektronik në të gjitha fazat e procesit në të gjithë zinxhirin e pagesave (nga fundi-në-fund, direkt nëpërmjet përpunimit), duke mundësuar kryerjen e të gjithë procesit të pagesës në mënyrë elektronike pa pasur nevojë për përdorimin përsëri të çelësave ose ndërhyrje manuale. Gjithashtu, kjo duhet të zbatohet për trajtimin e jashtëzakonshëm të transfertave të kreditit dhe transaksioneve të debitimit direkt, kurdo që është e mundur;
 - f) skemat e pagesave nuk duhet të vendosin asnjë kufi minimal për shumën e transaksionit të pagesës që lejon transfertat e kreditit dhe debitimet direkte, por nuk kërkohet të përpunojnë transaksionet e pagesave me vlerë zero;
 - g) skemat e pagesave nuk janë të detyruara të kryejnë transfertat krediti dhe debitime direkte që tejkalojnë shumën prej 999 999 999,99 euro.
- 2) Përveç kërkesave të përmendura në pikën 1, për transaksionet e transfertave të kreditit zbatohen kërkesat e mëposhtme:
 - a) Elementet e të dhënave të përmendura në nenin 4, pika 3, shkronja "a", janë si më poshtë:
 - i. emri i paguesit dhe/ose IBAN-i i llogarisë së pagesës së paguesit;
 - ii. shuma e transfertës së kreditit;
 - iii. IBAN-i i llogarisë së pagesës së përfituesit;
 - iv. kur është e mundur, emri i përfituesit;
 - v. çdo informacion për dërgesën.

- b) Elementet e të dhënave të përmendura në nenin 4, pika 3, shkronja "b", janë si më poshtë:
- i. emri i paguesit;
 - ii. IBAN-i i llogarisë së pagesës së paguesit;
 - iii. shuma e transfertës së kreditit;
 - iv. IBAN-i i llogarisë së pagesës të përfituesit;
 - v. çdo informacion për dërgesën;
 - vi. çdo kod identifikimi i përfituesit;
 - vii. emri i çdo pale referencë të përfituesit;
 - viii. çdo qëllim i transfertës së kreditit;
 - ix. çdo kategori e qëllimit të transfertës së kreditit;
- c) Përveç kësaj, elementet e mëposhtme të të dhënave të detyrueshme duhet t'i jepen OShP-së së marrësit nga OShP-ja e paguesit:
- i. BIC e OShP-së së paguesit (nëse nuk është rënë dakord ndryshe nga OShP-të e përfshira në transaksionin e pagesës);
 - ii. BIC e OShP-së së përfituesit (nëse nuk është rënë dakord ndryshe nga OShP-të e përfshira në transaksionin e pagesës);
 - iii. kodi i identifikimit të skemës së pagesës;
 - iv. data e shlyerjes së transfertës së kreditit;
 - v. numri i referencës së mesazhit të transfertës të kreditit të OShP-së së paguesit.
- d) Elementet e të dhënave të përmendura në nenin 4, pika 3, shkronja "c", janë si më poshtë:
- i. emri i paguesit;
 - ii. shuma e transfertës së kreditit;
 - iii. çdo informacion për dërgesën.
- 3) Përveç kërkesave të përmendura në pikën 1 të kësaj Shtojce, për transaksionet e debitimit direkt zbatohen kërkesat e mëposhtme:
- a) Elementet e të dhënave të përmendura në nenin 4, pika 4, shkronja "a", paragrafi (i), janë si më poshtë:
- i. lloji i debitimit direkt (i përsëritur, i vetëm, i pari, i fundit ose në kah të kundërt);
 - ii. emri i përfituesit;
 - iii. IBAN-i i llogarisë së pagesës së përfituesit që do të kreditohet sipas kërkesës për arkëtim;
 - iv. kur është e mundur, emri i paguesit;
 - v. IBAN-i i llogarisë së pagesës së paguesit që do të debitohet sipas kërkesës për arkëtim;
 - vi. referenca unike e mandatit;
 - vii. data në të cilën është nënshkruar mandati i paguesit;
 - viii. shuma e kërkesës për arkëtim;
 - ix. kur mandati është marrë përsipër nga një përfitues tjetër i ndryshëm nga përfituesi që ka lëshuar mandatin, referenca unike e mandatit siç është dhënë nga përfituesi fillestar që ka lëshuar mandatin;
 - x. identifikuesi i përfituesit;
 - xi. kur mandati është marrë përsipër nga një përfitues i ndryshëm

- nga përfituesi që ka lëshuar mandatin, identifikuesi i përfituesit fillestar që ka lëshuar mandatin;
- xii. çdo informacion për transfertën, nga përfituesi tek paguesi;
 - xiii. çdo qëllim të kërkesës për arkëtim;
 - xiv. çdo kategori e qëllimit të kërkesës për arkëtim.
- b) Elementet e të dhënave të përmendura në nenin 4, pika 4, shkronja "b", janë si më poshtë:
- i. BIC e OShP-së së përfituesit (nëse nuk është rënë dakord ndryshe nga OShP-të e përfshira në transaksionin e pagesës);
 - ii. BIC e OShP-së së paguesit (nëse nuk është rënë dakord ndryshe nga OShP-të e përfshira në transaksionin e pagesës);
 - iii. emri i palës referencë të paguesit (nëse është i pranishëm në mandatin e dematerializuar);
 - iv. kodi i identifikimit të palës referencë të paguesit (nëse është i pranishëm në mandatin e dematerializuar);
 - v. emri i palës referencë të përfituesit (nëse është i pranishëm në mandatin e dematerializuar);
 - vi. kodi i identifikimit të palës referencë të përfituesit (nëse është i pranishëm në mandatin e dematerializuar);
 - vii. kodi i identifikimit të skemës së pagesës;
 - viii. data e shlyerjes së kërkesës për arkëtim;
 - ix. referenca e OShP-së të përftuesit sipas kërkesës për arkëtim;
 - x. lloji i mandatit;
 - xi. lloji i debitimit direkt (i përsëritur, një herë, i parë, i fundit ose i kahut të kundërt);
 - xii. emri i përfituesit;
 - xiii. IBAN-i i llogarisë së pagesës së përfituesit që do të kreditohet sipas kërkesës për arkëtim;
 - xiv. aty ku është e mundur, emri i paguesit;
 - xv. IBAN-i i llogarisë së pagesës së paguesit që do të debitohet sipas kërkesës për arkëtim;
 - xvi. referenca unike e mandatit;
 - xvii. data e nënshkrimit të mandatit;
 - xviii. shuma e kërkesës për arkëtim;
 - xix. referenca unike e mandatit siç është dhënë nga përfituesi fillestar që ka lëshuar mandatin (nëse mandati është marrë nga një përfitues i ndryshëm nga ai që ka lëshuar mandatin);
 - xx. identifikuesi i përfituesit;
 - xxi. identifikuesi i përfituesit fillestar që ka lëshuar mandatin (nëse mandati është marrë përsipër nga një përfitues i ndryshëm nga përfituesi që ka lëshuar mandatin);
 - xxii. çdo informacion për dërgesën, nga përfituesi tek paguesi.
- c) Elementet e të dhënave të përmendura në nenin 4, pika 4, shkronja "c", janë si më poshtë:
- i. referenca unike e mandatit;
 - ii. identifikuesi i përfituesit;
 - iii. emri i përfituesit;
 - iv. shuma e arkëtimit;
 - v. çdo informacion për dërgesën;
 - vi. kodi i identifikimit të skemës së pagesës.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS**

VENDIM
Nr. 22, datë 3.4.2024

**PËR
RISHTYPJEN E KARTËMONEDHËS SHQIPTARE ME KURS LIGJOR, ME
PRERJE 200 LEKË DHE 500 LEKË**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 33 pikat 2 dhe 3, nenit 36, nenit 39 pika 2, dhe nenit 43, shkronjat "c" dhe "d", të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar; të nenit 16 të rregullores "Për shtypjen, rishtypjen, hedhjen dhe tërheqjen nga qarkullimi të kartëmonedhave dhe monedhave metalike shqiptare me kurs ligjor", miratuar me vendimin nr. 133, datë 7.12.2016, të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë; me propozim të Departamentit të Emisionit, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë rishtypjen e kartëmonedhës shqiptare me kurs ligjor me prerje 200 Lekë dhe 500 Lekë në përputhje me përcaktimet e anekseve 1 dhe 2, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Viti i shtypjes, i shfaqur në trupin e kartëmonedhave, të jetë viti 2017 për prerjen 200 Lekë dhe viti 2020 për prerjen 500 Lekë.
3. Ngarkohet Departamenti i Emisionit me zbatimin e këtij vendimi.
4. Ngarkohet Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë, me përjashtim të anekseve 1 dhe 2, që përmbajnë informacion të klasifikuar jopublik "sekret bankar".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI

ELVIS ÇIBUKU

KRYETARI

GENT SEJKO

TREGUESI I LËNDËS PËR BULETININ ZYRTAR, VËLLIMI 26, NUMËR 1, JANAR 2024

1. Licencë nr. 55, datë 3.11.2023, "Për të vepruar si institucion i parasë elektronike në Republikën e Shqipërisë"
2. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 2, datë 24.1.2024, për miratimin e rregullores "Për organizimin dhe funksionimin e Komitetit për Sistemet e Pagesave"
3. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 3, datë 24.1.2024, "Për miratimin e disa ndryshimeve në kontratën tip për riblerjen e titujve"
4. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 5, datë 24.1.2024 "Për miratimin e Strategjisë të Bankës së Shqipërisë "Për krijimin e monedhave pa kurs ligjor, përkujtimore dhe për qëllime numizmatike për 2024-2029""
5. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 6, datë 24.1.2024 "Për miratimin e Strategjisë të Bankës së Shqipërisë për edukimin dhe përfshirjen financiare, 2024-2026"
6. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 7, datë 24.1.2024 "Për miratimin e delegimit të kompetencës për nënshkrimin e marrëveshjes së bashkëpunimit midis Bankës së Shqipërisë dhe Akademisë së Sigurisë"

TREGUESI I LËNDËS PËR BULETININ ZYRTAR, VËLLIMI 26, NUMËR 2, SHKURT 2024

1. Vendim i Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë, nr. 644, datë 6.2.2024 "Për pezullimin e licencës së subjektit financiar jobankë "Micro Credit Albania""
2. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 9, datë 7.2.2024 "Për mbajtjen e pandryshuar të normës së interesit të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjella të riblerjes dhe të normave të interesit të depozitës njëditore dhe të kredisë njëditore në Bankën e Shqipërisë""
3. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr.10, datë 7.2.2024, "Për miratimin e udhëzimit "Për raportimin e incidenteve madhore"
4. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr.11, datë 7.2.2024 "Për disa ndryshime në rregulloren "Për përcaktimin e nivelit të vendimmarrjes në mbikëqyrjen e veprimtarive bankare dhe financiare""
5. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 12, datë 7.2.2024, "Për miratimin e rregullores "Për procedurat e krijimit dhe shtypjes së monedhave dhe kartëmonedhave pa kurs ligjor, përkujtimore për qëllime numizmatike, dhe medaljoneve përkujtimore nga Banka e Shqipërisë""

